

**SHPLLJE VENDI VAKANT PËR POZICIONIN:**  
**PËRGJEGJËS SEKTORI, SEKTORI I INVESTIMEVE DHE AFTERCARE,**  
**DREJTORIA E INVESTIMEVE**

**1. TË DHËNAT PËR POZICIONIN E PUNËS:**

**Emërtesa e pozicionit:** Përgjegjës Sektori i Sektorit të Investimeve dhe After Care

**Spektori:** Sektori i Investimeve dhe After Care.

**Drejtorja:** Drejtorja e Investimeve.

**Raporton te:** DREJTORI I DREJTORISË SË INVESTIMEVE

**QËLLIMI I PËRGJITHSHËM I POZICIONIT:** Përgjegjësi i Sektorit të Investimeve dhe After Care përgjigjet te Drejtori i Drejtorisë së Investimeve për zhvillimin e nxitjes së investimeve të huaja, duke u fokusuar në kompanitë e targetuara, për t'i kthyer në projekte për investime konkrete në Shqipëri.

Përgjegjësi i Sektorit të Investimeve dhe After Care ndihmon në hartimin e politikave për investimet e huaja me synim forcimin e klimës së biznesit, duke marrë të dhëna nga investitorët që kanë shprehur interes për të investuar në Shqipëri.

**2. DETYRAT KRYESORE:**

- a. Ndjek ecurinë e kompanive në mënyrë profesionale, duke vizituar dhe inspektuar kompanitë, nëpërmjet një plan veprimi të përcaktuar;
- b. Krijon pika të shumta lidhjeje për kompanitë e targetuara;
- c. Krijon dhe mban një regjistër me kompanitë e targetuara ndërkombëtare, me qëllim identifikimin e mundësive të investimeve;
- d. Përcakton grupet e targetuara në bazë të tregut të ofertës dhe kërkesës, duke marrë në konsideratë pikat e forta të rolit, që mund të luajë Shqipëria për të plotësuar kërkesat e investitorëve;
- e. Inkurajon grupet e targetuara për të investuar në Shqipëri, përmes komunikimeve të vazhdueshme;
- f. Bashkëpunon me palë të treta, me influencë, për kërkim rrjetesh dhe prezantime;
- g. Organizon dhe lehtëson vizitat e investitorëve në Shqipëri;
- h. Asiston investitorët për të përshtatur planin e biznesit, sipas akteve normative në fuqi;
- i. Zbaton strategjinë për kujdesin e mëtejshëm për investitorët në Shqipëri, duke i inkurajuar për të zhvilluar më tej veprimtarinë e tyre;
- j. Siguron të dhënat nga investitorët ekzistues dhe potencialë, për të përmirësuar më tej klimën e biznesit dhe rritur aftësitë konkurruese;
- k. Ndërton dhe mban një bazë të dhënash me informacionet për investitorët e huaj dhe investimet;
- l. Përcakton burimet që investitori do të sigurojë në vend, përcakton llojin e pjesëve dhe produkteve a shërbimeve që mund të jepen, si dhe indikatorët e vëllimit;

**3. KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDITATI**

### **Kushtet e përgjithshme që duhet të plotësojë kandidati janë:**

- a - Të jetë shtetas shqiptar;
- b - Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- c - Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- d - Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- e - Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;
- f.- Ndaj tij të mos jetë marrë asnjë masë disiplinore gjatë 6 muajve të fundit të periudhës kohore të punës.

### **Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme si vijon:**

- a. **Arsimi:** Master shkencor në shkenca juridike/marrëdhënie ndërkombëtare/ekonomike. Diplomat, të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë njohur paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi.
- b. **Tjetër:** Njohuri shumë të mira të specialiteteve brenda një fushe të caktuar profesionale dhe të politikave e programeve lidhur me fushën e specialitetit; aftësi për të ofruar drejtim teknik, për të koordinuar, kontrolluar dhe vlerësuar veprimtarinë e vartësve dhe përdorimin e burimeve; aftësi për të shkëmbyer ide dhe mendime teknike dhe për të argumentuar propozimet përkatëse; aftësi shumë të mira organizimi, komunikimi dhe prezantimi.

### **4. DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT**

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

- a - Jetëshkrim i plotësuar në përpunje me standardet e legjislacionit shqiptar;
- b - Fotokopje të diplomës . Për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njehsimi nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit;
- c - Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- d - Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- e - Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- f - Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;
- g - Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;

Aplikimi dhe dorëzimi i të gjitha dokumenteve të cituara më sipër, do të bëhet në zyrën e protokollit të institucionit me adresë: Rruga “Skerdilajd Llagami”, Nd.1, H.6, Tiranë.

Kandidatët e interesuar paraqesin kërkesën për aplikim ,dokumentacionin si më sipër dhe dokumentacionin vërtetues për kriteret e përgjithshme dhe të posaçme brenda datës: 10.09.2021.

## **5. REZULTATET PËR FAZËN E KONKURRIMIT**

Në datën **10.09.2021**, AIDA do të realizojë

- I. **Fazën e parë** të konkurrimit e cila konsiston në verifikimin e dokumentacionit të dorëzuar nga njësia përgjegjëse për menaxhimin e burimeve njerëzore:
  - a- Nëse dokumentacioni i paraqitur nga çdo kandidat vërteton plotësimin e kërkesave të përgjithshme dhe të veçanta në shpalljen për konkurrim
  - b- Nëse kandidatët plotësojnë kërkesat e përgjithshme dhe të veçanta të vendit të punës.
- II. **Faza e dytë** të konkurrimit e cila është faza e intervistimit të punonjësve të kualifikuar nga komisioni. Në këtë fazë komisioni bën një vlerësim të formimit të përgjithshëm të kandidatëve si dhe vizionit të tyre personal në lidhje me veprimtarinë e AIDA-s.

## **6. MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE**

Në përfundim të fazës së dytë komisioni i përzgjedhjes bën një vlerësim me pikë.Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatëve është **100 pikë**.

Për vlerësimin e kandidatëve, secili anëtar jep pikët e tij. Në përfundim pikët e grumbulluara mbledhen . Shuma e pikëve të mbledhura nga të gjithë anëtarët pjesëtohet me numrin e anëtarëve të tij dhe kjo vlerë përbën rezultatin përfundimtar.

Komisioni i Përzgjedhjes jep vlerësimin e tij sipas rregullores mbi kandidatët potencialë për punësim duke e shoqëruar me një raport përmbledhës.

Raporti përmbledhës së bashku me listën e 3(tre) kandidatëve që kanë arritur rezultate më të larta i paraqitet Drejtorit Ekzekutiv brenda një afati 5 (pesë) ditor nga përfundimi i vlerësimit.